




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Priliceno miratuar	30.05.2014		
Nr./Ordenit Org.broj	Num.	Shtetë Prilog	Vlers Vredno.
01-OB/766			



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti/na

Ne bazë të nenit 12.2 shkronja d) të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr 03/L-40 të Kuvendit të Republikës së Kosovës Gazeta zyrtare nr 28/2008, nenit 36 pika d) të Statutit të Komunës së Vitisë 01 nr 013/491 të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në seancën e mbajtur më 27.05.2014, aprovon këtë:

V E N D I M

PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS KOMUNALE, KOMPANISË KOSOVARE PËR DISTRIBUIM DHE FURNIZIM ME ENERGJI ELEKTRIKE "KEDS"

Neni 1

Me këtë vendim, Kuvendi i Komunës së Vitisë, I JEP në shfrytëzim pronat komunale Kompanisë Kosovare për distribuim dhe furnizim me energji elektrike "KEDS" të cilat evidentohen në ngastrat kadasrtrale me nr. 1473-0 me kulturë ujore Lumi "Morava" me sipërfaqe prej 73m² ZK Kabash, dhe pjesa e ngastrës me nr.25-1 Z.K. Smirë me sipërfaqe prej 73m² me kulturë bujqësore.

Neni 2

Dhënia e këtyre pronave komunale në shfrytëzim "KEDS" bëhet për kohë të caktuar prej 15 vitesh, me pagesë - kompensim sipas rekomandimit të Komisionit Komunal i formuar nga Kryetari i Komunës.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Kadastër Pronë dhe Gjeodezi dhe Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Shërbimit të Kuvendit,
2. Drejtorisë për Kadastër
3. Drejtorisë për Shërbime Publike dhe
4. Arkivit

KRYESUESI I KUVENDIT

Naim Pira

